VENDIM
Nr. 540, datë 9.7.2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ZBATIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT, DHE AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (GIZ) GMBH, SI PËRFAQËSUESE E QEVERISË GJERMANE DHE AGJENCI ZBATUESE, PËR PROGRAMIN "QENDRAT PËR MIGRACION DHE ZHVILLIM" (ZME)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së zbatimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH, si përfaqësuese e qeverisë gjermane dhe agjenci zbatuese, për programin "Qendrat për migracion dhe zhvillim" (ZME), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE ZBATIMI

ndërmjet

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)
Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Tiranë

- referuar në vijim si "partneri zbatues" -

dhe

AGJENCISË GJERMANE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR, (GIZ) GmbH
Dag-Hammarskjöld-Weg 1-5
65760 Eschborn

- referuar në vijim si "GIZ" -

në lidhje me projektin e Programit
"Qendrat për Migracion dhe Zhvillim" (ZME)

– referuar në vijim si "Projekti" –

Baza e marrëveshjes

Sa më poshtë vijon përbën bazën e kësaj marrëveshjeje:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, e datës 21 tetor 1988. (shihni Aneksin 1)

- Procesverbali Përmbledhës i Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mbajtur në Tiranë më 13-14 nëntor 2022. (shihni Aneksin 2)

- Autorizimi i Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), i datës 6.7.2023. (shihni Aneksin 4)

- Ligji Nr. 59/2018 "Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin "Këshillimi për Migracionin në Shqipëri". Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 20.9.2018. (shihni Aneksin 5)

1. Objektivi i projektit dhe treguesit

Historiku i projektit: Programi global "Qendrat për Migracion dhe Zhvillim" (ZME) është autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Programi po zbatohet në 13 vende, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Produktet dhe treguesit e projektit përcaktohen në nivel global midis selisë së projektit në Gjermani dhe palës autorizuese (BMZ) dhe zakonisht nuk janë të ndara në nivel kombëtar.

Objektivi i projektit
Strukturat partnere pajisen për të mbështetur në mënyrë të qëndrueshme grupe specifike të synuara me këshillimin për migracionin e rregullt për punësim dhe arsim, kthimin e vullnetshëm, riintegrimin e qëndrueshëm dhe migracionin rajonal.

GIZ dhe MEKI janë angazhuar bashkërisht për realizimin e këtij objektivi.

Produktet:

Produkti 1: Strukturat partnere kanë kapacitetin e nevojshëm për të ofruar shërbime specifike për grupet e synuara dhe specifike për barazinë gjinore lidhur me migracionin e rregullt dhe të sigurt për punësim dhe arsim, migracionin rajonal dhe riintegrimin.

Produkti 2: Shërbimet mbështetëse të strukturave partnere për riintegrimin socio-ekonomik janë specifike për grupet e synuara dhe specifike për barazinë gjinore dhe janë projektuar për të përmbushur nevojat e veçanta të emigrantëve të kthyer.

Produkti 3: Strukturat partnere janë fuqizuar për menaxhimin e migracionit rajonal të sigurt, të organizuar dhe të rregullt.

Produkti 4: Përmbajtja dhe procedurat e shërbimit të këshillimit për migracion të sigurt, të organizuar dhe të rregullt për arsim janë të përshtatura me nevojat e vendit të origjinës dhe vendit të destinacionit.

2. Kontributet nga GIZ

Në përputhje me Procesverbalin Përmbledhës të Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, të mbajtur në Tiranë më 13-14 nëntor 2022, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'i ofrojë GIZ deri në 3,851,307 euro (me fjalë: tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e shtatë euro) për kontributin gjerman deri më 31.12.2025. Kjo shumë do të përfshijë shpenzimet operacionale nga Organizata Zbatuese Gjermane.

Sigurimi i ekspertëve

GIZ do të vërë në dispozicion për projektin

- një Drejtues Ekipi i cili do të jetë përgjegjës për kontributin e programeve të migracionit të GIZ për kohëzgjatjen e fazës së përshkruar në Klauzolën 2 më lart dhe/ose
- një Menaxher Projekti për Shqipërinë, i cili do të koordinojë ekipin e ekspertëve teknikë
- deri në tetë ekspertë teknikë të brendshëm për realizimin e këshillimit dhe masave të ngritjes së kapaciteteve, si dhe
- deri në dy anëtarë stafi administrativ për të ndihmuar në zbatimin e projektit.

Furnizimi i materialeve dhe pajisjeve

GIZ do të ofrojë artikujt e mëposhtëm për pajisjen e infrastrukturës teknike:

- Pajisje dhe mobilie për zyrat e projektit, si dhe për zyrat e Qendrave të Këshillimit për Migracionin (DIMAK)[1] në Tiranë dhe në Shkodër.

Kostot operative dhe administrative

GIZ do të mbulojë kostot operative dhe/ose administrative që lidhen me përmbushjen e kontributit gjerman për projektin.

Kontribute të tjera

GIZ do të japë kontributet e mëtejshme shtesë:

- Masa të trajnimit, kualifikimit dhe ngritjes së kapaciteteve për tema që lidhen me migracionin, kthimin dhe riintegrimin dhe migracionin e rregullt (duke përfshirë migracionin rajonal)
- Aftësim për komunikimin dhe sensibilizimin për të përmirësuar aftësitë e Zyrave Rajonale të Punësimit për të komunikuar me grupin e tyre të synuar në nivel vendor.
- Mbështetje për grupet e cenueshme të popullsisë vendase dhe për emigrantët e kthyer, veçanërisht për sa u përket masave për gjenerimin e të ardhurave, këshillimit dhe mbështetjes për gratë.
- Shërbime konsulence në formën e studimeve ose këshillave nga ekspertët, si dhe aktivitete të tjera në formën e seminareve mbi riintegrimin, integrimin gjinor, zbatimin e Strategjisë së Re Kombëtare për Migracionin etj.
- Mbështetje për MEKI-n dhe AKPA-n lidhur me masat e rregullta të migracionit sipas Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit përkatës të Veprimit 2024-2026, veçanërisht duke pasur parasysh Kapitullin 24 të BE-së.
- Mbështetje për MEKI-n dhe AKPA-n lidhur me hartimin e një buletini informativ gjashtëmujor mbi aktivitetet e përbashkëta, që do të publikohet në faqet e internetit të partnerëve

Kontributet nga organizatat partnere

Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

MEKI (duke përfshirë edhe institucionet vartëse)

---

[1] DIMAK nënkupton **D**eutsches **I**nformationszentrum für **M**igration, **A**usbildung und **K**arriere, që përkthehet si "Qendra Gjermane e Informacionit për Migracionin, Arsimin Profesional dhe Karrierën"

- do të emërojë deri në katër anëtarë të personelit të MEKI-t dhe Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (AKPA), për të marrë pjesë në grupin drejtues
- do t'i kërkojë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe Ministrisë së Brendshme të emërojnë nga një përfaqësues për të marrë pjesë në Komitetin Drejtues.
- do të kryesojë mbledhjet e Komitetit Drejtues
- do të caktojë dhe krijojë kushtet për të garantuar pjesëmarrjen e stafit drejtues, teknik dhe administrativ nga MEKI dhe institucionet vartëse në masat e ngritjes së kapaciteteve të GIZ

MEKI (duke përfshirë edhe institucionet vartëse)

- Do të sigurojë që qendrat këshillimore për migracionin të GIZ të bashkëpunojnë ngushtë me strukturat këshillimore të MEKI-t dhe AKPA-s.
- Do të sigurojë që mbështetja e GIZ e ofruar në kuadër të kësaj marrëveshjeje të publikohet në faqet zyrtare të internetit të MEKI-t dhe AKPA-s dhe të jetë e aksesueshme për përfituesit individualë

Kostot

MEKI

- do të mbulojë TVSH-në për aktivitetet e projektit dhe shpenzime të tjera të lidhura me to që kryhen në Shqipëri (kostot operative dhe prokurimet) si dhe për prokurimet/importet ndërkombëtare, sipas ligjit në fuqi – që përfshin një nga regjimet: (i) shlyerjen nga buxheti i MEKI ose (ii) aplikimin e faturave pa TVSH nga subjektet për shërbime dhe mallra ofruar nga GIZ në kuadër të projektit, në momentin që ky opsion bëhet efektiv, deri në vlerën 175,000 euro (me fjalë:njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro), si dhe do të garantojë buxhetim të mjaftueshëm në kohën e duhur. Shuma do të planifikohet në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vitin 2025-2026, e cila do të marrë përsipër të mbulojë, brenda tavaneve të shpenzimeve të përcaktuara në programin buxhetor afatmesëm të periudhës përkatëse, detyrimet e TVSH-së të projektit.

Sigurimi i mjediseve, ndërtesave dhe ambienteve të punës

MEKI do të vërë në dispozicion të Projektit, pa pagesë, mjediset dhe ndërtesat në vijim, duke përfshirë edhe pajisjet dhe mobiliet, për sa kohë që këto pajisje dhe mobilie nuk janë ofruar nga GIZ:

- Zyrat e AKPA-s në rajonet pilot dhe më tej;
- Akses në sallat e konferencave në MEKI sipas nevojës, dhe
- Mjedise zyre për Qendrën e Këshillimit për Migracionin - DIMAK në Tiranë dhe në Shkodër.

Formatet e raportimit

MEKI

- do t'i japë GIZ-it modele dhe afate kohore të paracaktuara për raportimin e rregullt mbi projektin, si dhe për të kontribuuar në Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024 – 2030

dhe në planet e saj përkatëse të veprimit. Për pjesën e mbetur të periudhës së zbatimit, MEKI do t'ia paraqesë modelet dhe afatet e raportimit me email drejtuesit të ekipit të GIZ.

Kontribute të tjera

MEKI

- do të mbështesë bashkëpunimin me njësi të tjera kombëtare dhe rajonale të MEKI-t në zbatimin e projektit, si dhe me subjekte të tjera.

4. Dispozita të tjera

Vlerësimi

GIZ mund të ndërmarrë një vlerësim të projektit gjatë ose pas zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim, GIZ do të nënkontraktojë ekspertë/vlerësues për projektin. Në vlerësim do të marrin pjesë MEKI dhe institucionet e saj, të tilla si AKPA. Ajo do t'i asistojë në çdo rast ekspertët/vlerësuesit në punën e tyre dhe do t'u lejojë atyre të shqyrtojnë të gjitha dokumentet e nevojshme.

MEKI do të informohet në lidhje me rezultatet e vlerësimit nëpërmjet një raporti.

Komiteti Drejtues

GIZ dhe MEKI, si dhe institucionet e saj vartëse, e në veçanti AKPA, do të krijojnë një komitet drejtues (KD), i cili do të mblidhet deri në dy herë në vit për të monitoruar zbatimin e projektit dhe për të dakordësuar të gjitha ndryshimet që mund të nevojiten. Anëtarët e KD-së do të marrin informacionin përkatës (p.sh. planet e aktiviteteve dhe raportet, pikat për diskutim etj.) përpara mbledhjeve.

Përfaqësimi institucional në Komitetin Drejtues do të komunikohet midis palëve përmes kanaleve zyrtare të komunikimit. Çdo ndryshim në anëtarësinë e Komitetit do të duhet të dokumentohet me shkrim.

Për çdo mbledhje të Komitetit Drejtues do të mbahet dhe nënshkruhet një procesverbal, i cili do t'u shpërndahet të gjitha palëve.

Ndërprerja e kontributeve dhe zgjidhja e marrëveshjes

GIZ mund t'i ndërpresë kontributet e tij nëse:

- MEKI nuk përmbush detyrimet e saj që burojnë nga kjo marrëveshje ose nga marrëveshje të tjera që lidhen me të, ose
- lindin rrethana që pengojnë ose vënë në rrezik të konsiderueshëm realizimin e objektivit të projektit të përshkruar në Klauzolën 1 më lart.

Në rast se lind një prej rrethanave të përshkruara në fjalinë 1 më lart dhe kjo rrethanë vazhdon të ekzistojë edhe pas një afati kohor të dakordësuar nga GIZ dhe MEKI, ose nëse kjo rrethanë nuk eliminohet brenda

kësaj periudhe, GIZ, me miratimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, mund ta zgjidhë në mënyrë të parakohshme këtë marrëveshje.

Afati i marrëveshjes

Me përjashtim të sa parashikohet në Klauzolën 4 më lart lidhur me ndërprerjen e kontributeve dhe zgjidhjen e marrëveshjes, marrëveshja do të jetë e vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e fazës aktuale të projektit (që aktualisht parashikohet të zgjasë deri në dhjetor 2025). Afati i kësaj marrëveshjeje mund të zgjatet në rastin e një vonese në ekzekutimin e kontributit gjerman të parashikuar në këtë marrëveshje dhe në ekzekutimin e kontributeve të dakordësuara të MEKI-t.

Ndryshimet e marrëveshjes

Në rast se dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk ndihmojnë në arritjen efikase të objektivit të përcaktuar në Klauzolën 1 më lart, GIZ dhe MEKI mund t'i përshtatin apo t'i ndryshojnë këto dispozita me marrëveshje të përbashkët në çdo fazë gjatë zbatimit të projektit. Çdo ndryshim do të bëhet me shkrim.

GIZ mund ta zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme në rast të tërheqjes së autorizimit që i është dhënë nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Forma e shkruar

Ndryshimet dhe shtesat në këtë marrëveshje dhe çdo deklaratë dhe komunikim tjetër me rëndësi për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Në rastin e deklaratave dhe komunikimeve për GIZ-in, mjafton që ato të merren nga drejtuesi i ekipit të ekspertëve të vënë në dispozicion.

Marrëveshjet me organizata zbatuese të veçanta

Personi përgjegjës për kontributin nga GIZ dhe personi/personat përgjegjës për kontributet nga organizata partnere apo organizata të tjera zbatuese mund të lidhin bashkërisht një marrëveshje detyruese për detaje të mëtejshme lidhur me zbatimin e projektit (p.sh. në bazë të planit të veprimeve), ose t'i paraqesin këto detaje me shkrim në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme dhe, sipas nevojës, ta përshtatin çdo marrëveshje të tillë duke marrë në konsideratë zhvillimet në projekt.

Zbatimi i marrëveshjes

Për sa u përket dispozitave që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, duhet bërë referimi te dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik (shihni Aneksin 1), Procesverbali i Bisedimeve për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, i mbajtur në Tiranë më 13-14 nëntor 2022 (Aneksi 2), Ligjit Nr. 59/2018 "Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për projektin "Këshillimi për Migracionin në Shqipëri", miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 20.9.2018, referuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje (shihni Aneksin 5) si dheAutorizimin e dhënë për Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, datë 06.07.2023 (shihni Ankesin 4). Marrëveshja përfshin anekse të cilat janë pjesë përbërëse e saj.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lindin mosmarrëveshje ndërmjet palëve, sugjerohet që ato të zgjidhen me anë të bisedimeve. Nëse këto bisedime rezultojnë të pasuksesshme, komunikimi duhet të ndiqet përmes kanaleve diplomatike.

Hyrja në fuqi, kopjet

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të palës shqiptare për përfundimin e procedurave ligjore të brendshme. Ajo do të hartohet në katër kopje origjinale: dy në gjuhën angleze dhe dy në gjuhën shqipe. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretimin e tekstit, gjuha angleze do të ketë përparësi.

Tiranë, _____ 2025

Dr. Sonja Kurz,
Drejtuese për Shqipërinë
Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit
(GIZ) GmbH

Blendi Gonxhja
Ministër
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe
Inovacionit
Republika e Shqipërisë

Anekset

Aneksi 1:

Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, datë 21 Tetor 1988 (në gjuhën gjermane).

Annex_01_Dt.Rahme nabkommen Albanier

Rahmenabkommen 1988_al.pdf

Aneksi 2:

Procesverbali përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, në Tiranë më 13-14 nëntor 2022.

Protokoll RV DE_AL 2022.pdf

Aneksi 3: Përmbledhje e ndarjeve buxhetore për ZME

Marrëveshja qeveritare (Shënim verbal)	**Akti Ligjor**	**Marrëveshja ndërmjet partnerëve zbatues**	**Buxheti**
Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, datë 21 tetor 1988. **Procesverbali përmbledhës i Negociatave për Bashkëpunimin për Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, në Tiranë në datat 13-14 nëntor 2022.** **Autorizimi i dhënë Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim**		Marrëveshja e zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga MFE dhe GIZ në lidhje me projektin në kuadër të Programit Global të Qendrat për Migracionin dhe Zhvillimin (ZME).	EUR 3,851,307 (tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e shtatë euro)

Ndërkombëtar (GIZ) nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, datë 06.07.2023.

Aneksi 4 :

Autorizimi i dhënë Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, datë 06.07.2023.

ZME Auftragsschreiben.p

Aneksi 5:

Ligji nr.59/2018 "Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës të Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (GIZ) për projektin "Këshillimi i Migracionit në Shqipëri". Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 20.9.2018.

Amtsblatt_IA-Migrat ion_15Oct2018.pdf

Aneksi 6:

Plani operacional i projektit me aktivitete konkrete, afate kohore, kosto shoqëruese dhe rezultate të lidhura dhe tregues (indikatorë) në anglisht dhe shqip.

Action Plan ZME.pdf

Aneksi 7:
Produktet dhe treguesit:

Nr.	Produktet	Treguesit
1	Strukturat partnere kanë kapacitetin e nevojshëm për të ofruar shërbime specifike për grupet e synuara dhe specifike për barazinë gjinore lidhur me	Nga 400 persona të këshilluar lidhur me me migracionin e rregullt dhe të sigurt drejt Bashkimit Evropian ose brenda rajonit. (50% e tyre gra).

	migracionin e rregullt dhe të sigurt për punësim dhe arsim, migracionin rajonal dhe riintegrimin.	
2	Shërbimet mbështetëse të strukturave partnere për riintegrimin socio-ekonomik janë specifike për grupet e synuara dhe specifike për barazinë gjinore dhe janë projektuar për të përmbushur nevojat e veçanta të emigrantëve të kthyer.	470 persona te këshilluar për mundësitë socio-ekonomike, të kthyer nga Gjermania, BE-ja dhe rajoni dhe 40 janë individë të disavantazhuar nga popullsia vendase (në secilin rast, 50% janë gra).
3	Strukturat partnere janë fuqizuar për menaxhimin e migracionit rajonal të sigurt, të organizuar dhe të rregullt.	Struktura shtetërore partnere ka rritur burimet e tyre financiare dhe njerëzore për ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes specifike për grupet e synuara dhe specifike për barazinë gjinore, në lidhje me çështjet përkatëse të migracionit.
4	Përmbajtja dhe procedurat e shërbimit të këshillimit për migracion të sigurt, të organizuar dhe të rregullt për arsim janë të përshtatura me nevojat e vendit të origjinës dhe vendit të destinacionit.	Grupet e interesit i vlerësojnë kontributet e 2 partneriteteve me aktorë nga qeveria, shoqëria civile dhe sektori privat si të dobishme për përmirësimin e sasisë ose cilësisë së shërbimeve (specifike për barazinë gjinore) për grupet e synuara.